



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201901596/2

Tiranë ___/___/2019

Lënda: *Rekomandim për garantimin e të drejtave të personave të moshuar, të cilët janë të akomoduar në Shtëpinë e të Moshuarve Fier.*

Drejtuar: **Z. Armando SUBASHI**
Kryetar i Bashkisë

TIRANË

Znj. Luneda SUFALI
Drejtoreshë e Përgjithshme e Shërbimit Social
Shtetëror

TIRANË

Për dijëni: **Znj. Daniela HASIMAJ**
Drejtoreshë e Shtëpisë së të Moshuarve

FIER

Të nderuar,

Në ushtrimin e mandatit të tij kushtetues në promovimin, parandalimin e shkeljes dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të ligjshme të individëve, nga veprimet e paligjshme dhe të parregullta të administratës publike dhe të të

tretëve që veprojnë për llogari të saj, Avokati i Popullit ka si prioritet të tij, promovimin dhe garantimin e të drejtave të personave të moshuar.

Aktiviteti ynë është shtrirë në disa aspekte konkrete të mbrojtjes së këtyre personave, me një qasje proaktive dhe të dedikuar, duke zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme me iniciativë, inspektime në Shtëpitë e të Moshuarve në të gjithë vendin.

Një nga këto inspektime është zhvilluar nga përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit, më datë 13.12.2019, në Shtëpinë e të Moshuarve, Fier.

Avokati i Popullit, pasi shqyrtoi informacionin nga monitorimi i realizuar, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor, t'Ju parashtrijë përfundimet e këtij monitorimi, si më poshtë vijon.

Objektivat e inspektimit:

- Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit në vitin 2017 si dhe gjendja aktuale,
- Vlerësimi i dokumentacionit, procedurave dhe personelit, në zbatim të legjislacionit në fuqi,
- Respektimi i të drejtave të personave të moshuar, të cilët janë akomoduar në këtë institucion rezidencial, në zbatim të standardeve ligjore, të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit.

Metodologjia

Grupi i inspektimit i institucionit të Avokatit të Popullit, i përbërë nga juristë, si metodologji pune ka përdorur:

- ***Së pari***, zhvillimin e bisedave paraprake me drejtuesen e këtij institucioni publik rezidencial, informacion, i cili është hedhur në një formular standard për inspektimin.
- ***Së dyti***, monitorimin e zbatimit të standardeve ligjore të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për qendrat rezidenciale për të moshuarit.
- ***Së treti***, monitorimin e mjediseve dhe kushteve të institucionit (Shtëpia e të Moshuarve, Fier), ku ofrohen shërbime për personat e moshuar.
- ***Së katërta***, komunikimi me disa të moshuar, përfitues të shërbimeve të përkujdesjes, të akomoduar në Shtëpinë e të Moshuarve, Tiranë.

Rekomandimet e vitit 2017 dhe niveli i zbatimit të tyre

Nga inspektimi i kryer më datë 05.05.2017 në Shtëpinë e të Moshuarve në Fier, pas problemeve të konstatuara, ju jemi drejtuar me rekomandime për marrjen e masave për:

-Shtimin në organikë me 2 kujdestarë, mjek me kohë të plotë, psikiatër, psikologë dhe roje objekti.

-Shtim fondi për vendosjen e kamerave dhe sistemit të alarmit në çdo dhomë.

-Mundësinë e vënies në dispozicion të një mjete.

-Të lidhet kontrata e punës ndërmjet personelit të Shtëpisë së të Moshuarve Fier dhe Bashkisë Fier, e cila të nënshkruhet dhe t'u jepet atyre një kopje e kontratës së nënshkruar.

-Të ketë vijimësi të rikonstruksionit të kësaj godinë, e cila është e vjetër dhe ka nevojë për rregullime në vijimësi.

Në përgjigje të rekomandimeve të sipërcituara, nga Bashkia Fier na u kthye përgjigja e mëposhtme:

Për rekomandimin nr.1, është shtuar një roje dhe mjeku me shërbim 4-orësh. Po punohet për organikën e gjithë Bashkisë Fier dhe në varësi të ngarkesës dhe ndarjes funksionale, do të shihet mundësia e shtimit të saj në këtë qendër.

Për rekomandimin nr.2, janë vendosur kamerat dhe sistemi i alarmit në çdo dhomë.

Për rekomandimin nr.3, do shihet mundësia për një mjet në dispozicion të institucionit, por në kushtet e deritanishme është e vështirë, pasi ka mangësi në ndërmarrjet e shërbimeve publike të Bashkisë.

Për rekomandimin nr.4, është lidhur kontrata e punës ndërmjet Bashkisë Fier dhe personelit të Shtëpisë së të Moshuarve Fier, duke i dhënë një kopje të saj.

Për rekomandimin nr.5, janë çelur disa herë fonde për mirëmbajtjen dhe rregullimin e ambjenteve të saj. Gjithashtu është çelur fondi për naftë për kaldajën për periudhën e dimrit, shtim të orarit të mbajtjes në punë të kaldajës për ditët shumë të ftohta.

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve, rezultoi se:

- Rekomandimi për shtim në organikë me organikë me 2 kujdestarë, mjek me kohë të plotë, psikiatër, psikologë dhe roje objekti, është realizuar pjesërisht. Është shtuar një roje objekti, i cili punonte në turnin e parë.
- Rekomandimi për shtim fondi lidhur me vendosjen e kamerave dhe sistemit të alarmit në çdo dhomë, është realizuar. Është vendosur sistemi i alarmit në çdo dhomë si dhe në të gjitha ambjentet e këtij institucioni.
- Rekomandimi për mundësinë e vënies në dispozicion të një mjeti, nuk është realizuar.
- Rekomandimi për lidhjen e kontratës së punës ndërmjet të punësuarve në Shtëpinë e të Moshuarve Fier dhe Bashkisë Fier, është realizuar. Kopjet e kontratave, të nënshkuara, mbahen në Bashkinë Fier dhe në institucion.
- Rekomandimi për vijimësinë e rikonstruksionit të godinës, e cila është e vjetër dhe ka nevojë për rregullime herëpashershme, është realizuar. Vazhdimisht rikonstruktohen ambjente të ndryshme të godinës sipas nevojave.

Gjendja aktuale

-Profili i Shtëpisë së të Moshuarve, Fier

Shtëpia e të Moshuarve Fier, është një institucion publik rezidencial, ku trajtohen persona të moshuar, të cilët kanë mbushur moshën për pension pleqërie, sipas legjislacionit në fuqi.

Misioni i këtij institucioni është që të ofrojë ndihmë dhe shërbime sociale të qëndrueshme dhe me standarde bashkëkohore, me qëllim që të nxitet pavarësia dhe integrimi i të moshuarve në jetën normale, duke bashkëpunuar me shoqërinë civile, komunitetin, biznesin, me synim plotësimin e nevojave sociale dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së të moshuarve.

Ky institucion është nën administrimin e Bashkisë Fier dhe me mbështetje financiare të garantuar nga programet e mbrojtjes sociale të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror. Është përgjegjës për mbarëvajtjen e punës dhe raporton në mënyrë periodike në Shërbimin Social Shtetëror dhe Bashkinë Fier, përsa i përket buxhetit, zbatimin e projekteve, menaxhimin e ndihmave humanitare nga donatorë të ndryshëm, paraqitjen e informacionit statistikor.

Shtëpia e të Moshuarve, Fier, ofron shërbime sipas standardeve të miratuara për personat e moshuar, të cilët janë të vetmuar dhe të braktisur, sipas verifikimeve të kryera nga punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit dhe që kanë nevojë për kujdes të vazhdueshëm.

Organizimi dhe funksionimi i këtij institucioni, së bashku me përshtimet e punës, të drejtat dhe detyrimet e përfituesve, janë të parashikuara në Rregulloren e Brendëshme të tij, miratuar nga Drejtori i Drejtorisë së Shërbimit Social në Bashkinë Fier, e cila është e afishuar në ambjentet e institucionit.

Zbatimi i standardeve të ofruara të shërbimeve sociale, si një proces vazhdueshëm, monitorohet nga Bashkia Fier, Shërbimi Social Shtetëror, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Fier; nga inspektimet e kryera të Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Drejtorisë së Shëndetit Publik, Agjensisë Kombëtare të Ushqimit etj.

-Numri i përfituesve dhe shërbimet e ofruara

Nga konstatimi paraprak u evidentua se, në këtë Shtëpi të Moshuarish mund të akomodohen dhe ofrohen shërbime për persona të moshuar, mbi moshën 60 vjeç për femra dhe 65 vjeç për meshkuj. Kapaciteti i institucionit për ofrimin e shërbimeve është për 60 persona të moshuar.

Gjatë inspektimit u konstatua se në të trajtoheshin 54 të moshuar (16 femra dhe 38 meshkuj), nga të cilët 15 të moshuar me probleme të rënda shëndetësore, të paafte fizikisht dhe me probleme të shëndetit mendor, të cilët kërkojnë kujdes të veçantë.

Përfitues të pensionit të pleqërisë janë 50 të moshuar, të cilët nuk paraqitën ankesa ndaj stafit për këtë shërbim.

Për çdo përfitues të shërbimeve të këtij institucioni ishte hartuar një plan kujdesit shëndetësor, sipas nevojave specifike për secilin të moshuar, bazuar në kartelën shëndetësore, e cila mbahet të mjeku i familjes. Plani i kujdesit shëndetësor hartohet çdo muaj nga mjekja, e cila prej vitesh punon me kohë të pjesshme në këtë institucion, e cila çdo ditë i takon të moshuarit, i mat tension dhe bisedon me ta për çdo problem që ata i shqetëson. Gjithashtu të gjithë të moshuarit kishin të pasqyruar në kartelat e tyre dhe analizat klinike dhe biokimike.

Një pjesë e medikamenteve me të cilat trajtoheshin të moshuarit ishin të rimbursueshme dhe nuk kishte probleme me marrjen e tyre, ndërsa pjesa tjetër e medikamenteve që nuk ishin të rimbursueshme, mbulohen nga vetë të moshuarit. Medikamentet për ftohjen dhe virozat e gripit, mbulohen me

fondet e institucionit. Vaksinat kundër gripit u bëheshin të moshuarve dhe gjithë stafit çdo vit.

Shërbimi dentar realizohet individualisht, nga vetë të moshuarit, me shpenzimet e tyre dhe jo me fondet e institucionit. Vetëm vizitat dentare bëheshin falas.

Plani i përkujdesit për të moshuarit hartohet çdo vit, ndërsa rishikohej ecuria e të moshuarit çdo 6 muaj. Nëse konstatoheshin probleme më specifike, plani i përkujdesjes rishikohej edhe më herët.

-Burimet njerëzore

Struktura e përcaktuar e personelit të këtij institucioni rezidencial përbëhet nga 20 punonjës me kohë të plotë si dhe 2 (dy) punonjës me kohë të pjeshme: 1(një) mjek, 1(një) sanitare, me fondet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Gjatë turnit të parë punojnë 1(një) kujdestare dhe 6(gjashtë) sanitare, nga të cilat 3(tre) sanitare janë ngarkuar me detyra të tjera: në lavanderi e magazinë.

Gjatë turnit të dytë punojnë 1(një) kujdestare, 1(një) sanitare dhe kuzhinierja.

Gjatë turnit të tretë punon vetëm 1(një) kujdestare.

Me trajtimin e problemeve psiko-sociale, të përfituesve të shërbimeve të ofruara është e ngarkuar 1(një) punonjëse sociale.

Shërbimet shoqërore ofrohen nga 5 kujdestarë.

Vlerësimi i punës së stafit bëhet 1 herë në vit nga drejtuesja e institucionit dhe një kopje dërgohet në Bashkinë Fier.

Trajnimet janë bërë nga vetë stafi për tematika të ndryshme dhe për përmirësimin e mëtejshëm të punës. Ka patur vetëm një trajnim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale vetëm për shërbimet e financës.

Megjithatë nga konstatimet e kryera gjatë inspektimit, gjykojmë se numri i punonjësve që ofrojnë shërbime shoqërore në këtë qendër është i pamjaftueshëm, ndaj edhe nevojitet shtimi i këtij numri me qëllim garantimin e cilësisë së shërbimeve sociale për personat e moshuar.

-Ambjentet e Shtëpisë së të Moshuarve, Fier

Shtëpia e të Moshuarve në Fier ndodhet në një godinë dy katëshe. Në katin e parë të kësaj godine gjenden dhomat, ku ishin sistemuar të moshuar me

probleme shëndetësore, kryesisht meshkuj. Në katin e dytë ishin sistemuar të moshuarit e tjerë.

Në çdo dhomë qëndrojnë nga dy të moshuar. Tualetet nuk janë nëpër dhoma. Të moshuarit çohen natën, shkojnë në tualet shumë shpesh dhe kjo krijon problem për ta.

Ambjentet e këtij institucioni janë rikonstruktuar vazhdimisht dhe kudo mbizotëronte pastërtia. Në vitin 2017, 2018 dhe 2019, me fondet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka vijuar mirëmbajtja e godinës. Ky proces rikonstruksioni do vijojë deri në përfundim të plotë të të gjitha ambienteve të këtij institucioni. Aktualisht po punohet me sistemimin e fasadës në pjesën e mbrapme të institucionit si dhe sistemimi i oborrit. Në oborr ishin vendosur shtylla ndriçimi.

Në një ambient të veçantë ishin të afishuara rregulloret e jetës së brendshme, standardet që duhet të respektojnë punonjësit e këtij institucioni, si dhe ishte vendosur edhe kutia e ankesave, ku depozitoheshin ankesat e të moshuarve.

Kutia e ankesave hapej një herë në muaj, nga përfaqësuesi i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror në praninë e një të moshuari.

Mjetet për shmangien e rreziqeve që mund të vijnë nga rastet e emergjencave civile, ishin të vendosura në vende të veçanta në korridore. Kolaudimi i tyre bëhet çdo vit. Ishte vendosur sistem alarmi në rast të rënies së zjarrit si dhe shkallët e emergjencës. Gjithashtu ishte hartuar një plan i evakuimit të të moshurve në rast emergjence. Stafi ishte trajnuar për përdorimin e mjeteve kundër zjarrit.

Sistemi i ngrohjes realizohej me kaldajë, i cili funksiononte, duke e alternuar me ajër-ngrohëse, pajisje individuale, të cilat ishin të vendosur në çdo dhomë. Ndërsa sistemi i ftohjes realizohej me anë të ventilatorëve, të vendosura edhe këto në çdo dhomë.

Gjatë inspektimit nuk u paraqiten probleme për furnizimin me artikujt hotelerike. Ky furnizim përgjithësisht realizohej nga fondet e institucionit si dhe nga donacione të ndryshme.

Ambjenti i kuzhinës ishte i pastër, i pajisur me soba industriale, frigorifer etj. Kampionët e ushqimeve për të treja vaktet e çdo dite ruheshin në frigorifer.

Kuota ushqimore është rritur, nga 300 lekë në 360 lekë në ditë, e mjaftueshme për përfituesit, gjë e cila u konfirmua edhe nga vetë të moshuarit.

Për përcaktimin e menysë dhe oraret e vakteve të ngrënies, merrej mendimi i të moshuarve si dhe preferencat e tyre në gatime. Menuja është javore dhe

çdo ditë afishohet te dera e mencës. Shërbimi i vakteve u bëhej edhe nëpër dhoma, kryesisht të moshuarave femra, për shkak të moshës.

Gjatë inspektimit të kryer në mencë, të moshuarit po konsumonin vaktin e drekës. Nga intervistimi i bërë dhe ajo ç'ka u konstatua, të moshurit ishin të kënaqur me ushqimin e servirur.

-Jeta social-kulturore

Përsa i përket jetës sociale, nga informacioni që u mor gjatë inspektimit u konstatua se organizoheshin aktivitete të ndryshme: ditëlindje, festa fetare, festat zyrtare, vizita në plazh gjatë sezonit të verës, në Darzez dhe Zvërnec. Disa nga të moshuarit ndjekin ritet fetare.

Gjatë kohës së lirë, ka të moshuar që kujdesen për lulishten dhe verandën.

Te moshuarat, bëjnë punime dore dhe nga shitja e tyre i përfitojnë të ardhurat vetë.

Të moshuarit vizitohen nga të afërmit e tyre. Ata qëndrojnë në oborrin e institucionit ose në dhomat e tyre. Kur i marrin familjarët për të qëndruar disa ditë me ta, nga drejtuesja e institucionit hartohet fletë-dalja nga institucioni.

Është kthyer në traditë prej vitesh, që nxënës të shkollës së mesme profesionale “*Rakip Kryeziu*”, Fier, vijnë vullnetarisht pranë të moshuarve për të kryer disa shërbime, bashkëbisedime me të moshuarit, i masin tensionin, etj.

Nga biseda e bërë me të moshuarit, nga ana e tyre u shpreh mirënjohja dhe falenderimi për përkushtimin në punë të stafit të këtij institucioni.

Nuk u paraqitën ankesa ndaj stafit nga të moshuarit. Ata konfirmonin gatishmërinë e stafit për të plotësuar çdo kërkesë të tyre.

-Problematikat e konstatuara:

- Konstatohet se nuk ka kapacitete të mjaftueshme njerëzore, të domosdoshme për të ofruar shërbimet sipas standarteve të përkujdesit shoqëror, kryesisht me kujdestarë. Nga konstatimi i bërë, siç jemi shprehur edhe më sipër, në çdo turn ka vetëm 1(një) kujdestare. Minimalisht, duhet të jenë 2(dy) kujdestarë në çdo turn.
- Konstatohet mungesa e një psikologu ose psikiatri, pasi në këtë qendër ka të moshuar me probleme mendore, që kanë nevojë për asistencën e tyre. Përpos kësaj, krijohen situata problematike me të moshuarit e tjerë.

- Konstatohet mungesa e një automjeti, i cili është i rëndësishëm për transportin e të moshuarve, si për marrjen e shërbimeve shëndetësore, ashtu edhe për kryerjen e aktiviteteve të ndryshme.
- Konstatohet se, në lavanderi shërbimi kryhej me anë të 5(pesë) lavatriçeve familjare, jo industriale. Pavarësisht se nuk u paraqit asnjë shqetësim, rezultonte se kishte harxhim energjie dhe kjo ndikon në shpenzimet e institucionit.
- Konstatohet se, nuk ka një regjistër për pasqyrimin e vizitave të bëra nga familjarët apo të afërmit e të moshuarve, me qëllim monitorimin e tyre.
- Konstatohet se, në organikën e këtij institucioni nuk ka “magaznier” dhe detyrën e tij e kryen një sanitare.
- Së fundmi, konstatohet se, për stafin e punësuar në Shtëpinë e të Moshuarve Fier, nuk ka patur trajnime nga Shërbimi Social Shtetëror dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Sa më sipër, në funksion të jetesës së tyre me dinjitet e në mënyrën më të mirë të mundshme, duke gëzuar plotësisht të drejtat e tyre themelore të sanksionuara në aktet ligjore e nënligjore; duke marrë në konsideratë konstatimet e renditura më sipër, Avokati i Popullit gjykon se pavarësisht punës rigoroze të bërë në këtë institucion, kërkohet një angazhim më i madh dhe një bashkëpunim më i mirë ndërinstitutional, për përmbushjen e standardeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit e akomoduar në Institucionet Rezidenciale.

Për këtë qëllim, për t’iu përgjigjur nevojave të tyre dhe për një jetesë sa më dinjitoze për të moshuarit në Shtëpinë e të Moshuarve Fier, në mbështetje të nenit 21, të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave përkatëse për shtim në organikë të pozicionit të punës me kujdestarë me kohë të plotë, magaznier dhe psikiatër/psikolog.
- Marrjen e masave për të shtim fondi buxhetor, me qëllim mundësimin e vendosjes së një automjeti.

- Marrjen e masave për kryerjen e trajnimeve lidhur me zbatimin e standardeve shoqërore për stafin e Shtëpisë së të Moshuarve, Tiranë.
- Marrjen e masave për mundësimin e vendosjes së lavatriçeve industriale.
- Marrjen e masave për pasqyrimin e vizitave të familjarëve dhe të të afërme të të moshuarve në një regjistër, e cila të firmoset nga i moshuari, vizitori dhe nga kujdestarja e turnit.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar: “*Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit*”.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të të moshuarve, lutemi shqyrtimin e rekomandimeve të sipërcituar.

K O M I S I O N E R

Vilma SHURDHA

Konc.M.Morina

dt. 30.12.2019